



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-22628/19  
Kaçanik, 30.07.2019

### **PROCESVERBAL**

Nga mbledhja e **VII (Shtatë)** e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 30 Korrik 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimi ishin 24 anëtarë, në ndërkohë arriti edhe anëtarët: Lirije Shurdhani, Hafize Sallahu dhe Bekim Koxha, kështu që pjesëmarrës të këtij takimi konstatohet së ishin 27 anëtarë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtoret e drejtorive: Ramadush Osmani, Fatmir Loku, Ukshin Qallaku, Festim Neziraj dhe Diana Reka, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Iliriana Berisha, Arbnora Kuka, Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi dhe Hidajete Guri.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhja u monitorua përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët e KK. Pjesëmarrës në mbledhje janë, 24 anëtarë, ndërkaq 3 anëtarët tjerë pritet të vijnë në ndërkohë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VII-të (Shtatë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës, për vitin 2019, data 30 Korrik, me këtë:

### **REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i Auditimit për Komunën e Kaçanikut për vitin finansiar të përfunduar me 31 Dhjetor 2018;
3. Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhënë në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare të Auditimit për PFV 2018;

4. Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën: Janar-Qershori 2019;
5. Raporti i Përformances Komunale për vitin 2018;
6. Propozim Vendimi për rialokimin dhe transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 ;
7. Raporti final i rekomandimit të Panelit Përgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut; dhe
8. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr.104/02-18863/19- të datës 28.06.2019 –Për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

Fillimisht a jeni të pajtimit të hynë në rend pune pika e 8, për shkak së një anëtar i këtij komisionit të ankesave ka ofruar dorëheqje, ndërkëq komisioni duhet të funksionoj, në anën tjetër Kuvendi i Komunës nuk ka mbledhje deri në muajin shtator. Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Atëherë Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli, Rendin e propozuar të punës me shtimin e pikës 8-të e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

#### APROVOJ

**Rendin e Punës në përbërje prej 8 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbal i mbledhjes së VI-të (Gjashtë) të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### APROVOJ

**Procesverbalin nga mbledhja e VI-të (Gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të datës 28 Qershori 2019. / Lënda: 01Nr. 60/01-18304/19.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, Para se me kaluar në pikët tjera të rendit të punës, nëse ka kush ndonjë pyetje apo kërkesë, lë të urdhëroj:

#### **Pyetjet dhe Kërkesat**

- z. Shpend Krusha**, Shprehi shqetësimet lidhur me banorët e lagjes të “ Saniteksi” të afér 80 shtëpive të banimit dhe të disa shtëpive të lagjeve të tjera të cilët banojnë në lartësi, përmungesën e ujit të pijes. Lidhur me këtë problematikë z. Krusha theksoj së duhet bërë një zgjidhje, ashtu që me biseduar me drejtorin e kompanisë së ujësjellësit “ Lypetenii” së a ka mundësi me u furnizuar me ujin e pijes qytetarët të cilët banojnë në lartësi (jo vetëm në qytet por edhe në fshatra), përmes pompave të ujit. Uji është çështje jetike e njeriut, andaj mungesa e ujit mund të sjellë edhe probleme të infeksioneve të qytetarëve të komunës.

**z. Adnan Reka,** Kérkojmë nga ekzekutivi komunal që çështjen e lumbit Nerodime, ta fus si prioritet tē prioriteteve pavarësish koston e projektit. Duke pasur parasysh dëmet dhe imazhin që ky lum po ia shkakton më shumë se gjysmës së territorit tē Komunës së Kaçanikut, ne mendojmë se përveç impiantit për trajtimin e ujërave tē zeza ka edhe alternativa tjera me kosto shumë më tē vogël, por që në masë tē madhe do ta zbusnin gjendjen aktuale tmerruese tē lumbit Neredime. Komuna jonë nuk mund tē ngelet peng nën mëshirën apo vullnetin e mirë tē Komunës së Ferizajt, ne duhet tē mendojmë dhe tē veprojmë urgjentisht dhe tē mos lejojmë që Komuna e cila dikur krenohej nga bukuritë natyrore që shtrihet mbi dy lumenj, tani tē turpërohet nga degradimet që ne po lejojmë t'i ndodhin lumenjve tē komunës tonë dhe po bëhem shkaktarë direkt apo indirekt i këtij tmerrri.

**z. Ekrem Kyçyku,** Kam një kérkesë në emër tē banorëve tē lagjes, "Mejdi Dalloshi" në Kaçanik për lëvizje tē lirë tē qytetarëve në atë rrugë, sepse në mungesë tē parkingjeve, parkohen auto veturat në atë rrugë, me çka po iu krijohet vështirësi qytetarëve tē asaj lagjeje tē lëvizin lirshëm. Lidhur me këtë problematikë kérkoj një angazhim më tē madh tē organet relevante tē komunës për krijimin e kushteve qytetarëve tē komunës për lëvizjen e lirë në atë rrugë.

#### **z. Shemsedin Luzha,**

1. Kam një kérkesë në emër tē lagjes së f. Begracë, për çështjen e mungesës së ujit tē pijes, për shkak tē dëmtimit tē rrjetit tē ujësjellësit.
2. Kérkesa tjetër është për: Çështjen e ndotjes së lumbit Neredime, tē cilën e potencoju edhe parafolësi im, Adnan Reka.
3. Kérkesa tjetër; Në emër tē f. Begracë e ngriti çështjen e problemit tē kanalizimit, sepse gypi i kanalizimit është mbi tokë. Lidhur me këtë çështje ka pasur kérkesë nga f. Begracë për rregullimin e gypit në fjalë, por nuk është marrë ndonjë veprim në këtë drejtim nga organet relevante tē komunës.

**znj. Afërdita Shehi.** Kérkoj tē merren veprime tē nevojshme nga organet relevante tē komunës për ndërtimin e objektit, "Kulla e Hasanit".

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kérkesa tē tjera, përgjigjet do t'i merrni nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese tē Kuvendit tē Komunës. Atëherë procedojmë me pikët e radhës tē rendit tē punës; Kalojmë në pikët vijuese sipas rendit tē punës:

**2.** Raporti i Auditimit për Komunën e Kaçanikut për vitin finanziar tē përfunduar me 31 Dhjetor 2018;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Lidhur me këtë pikë për sqarime tē nevojshme, drejtori i DEFZH nuk është prezent për shkaqe tē arsyeshme, ndërkaq Kryetari i Komunës, Besim Ilazi është prezent për më dhënë sqarime tē nevojshme sipas nevojave që kërkohet, ndërkaq sipas nevojave që kërkohet mund tē kyçen edhe drejtorët e drejtorive që janë prezent në mbledhje për sqarime tē nevojshme lidhur me çështjet e drejtorive tē tyre. Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka,** Për aq sa dimë ne, auditori i përgjithshëm jep konstatime, rekomandime dhe opinione. Në raportin e tij për vitin 2018, Auditori kishte dhënë një opinion të ‘pamodifikuar me theksim të çështjes’ por, gjuhën që përdor auditori ndoshta jo të gjithë mund t’i kuptojnë njëjtë, prandaj edhe përpiken t’i interpretojnë ashtu si duan ata. Mënyra se si ne e kemi kuptuar auditorin, është kjo, Auditori konstaton se: · Afro 350,000 euro, para nga buxheti komunal për vitin 2018, në kategorinë e investimeve kapitale nuk janë shpenzuar, I janë kthyer buxhetit të Kosovës.· Inkasimi i të hyrave nga qiradhënia e pronave publike është e ulët, nga 30.000 euro të planifikuara vetëm 16,682 euro janë paguar (65%).· Vazhdimi i kontratave me qiramarrësit e pronës publike, edhe pse qiramarrësit nuk l kryejnë obligimet paraprake, prapë i vazhdohet kontrata.· Pranimi i punëtorëve për shërbime të veçanta (kontratë në vepër) pa shpallje të konkursit. (2 raste).· Punëtoreve për shërbime të veçanta ju vazhdohet kontrata më tepër se 6 muaj, në kundërshtim me ligj.· Deklarimi i pagave të punëtorëve për shërbime të veçanta nuk bëhet në përputhje me ligj.· Mbivlerësim të investimeve kapitale (16,860 euro) dhe në anën tjetër nën vlerësim të pasurive jo financiare me vlerë nën 1000 euro.· Të gjitha dosjet e prokurimit për investime kapitale dhe për mallra dhe shërbime janë me kontrata shtesë, me vlerën 10% të kontratës.. Gjatë vitit 2018, pajisjet me vlerë nën 1000 euro “të blera” për shumën prej afro 140,000 euro nuk janë të regjistruala (mungojnë), bile kjo është vërejtja e dytë e auditorit për të njëjtën gjë (mbase edhe e ka ‘theksuar si çështje’ dhe thotë ‘kemi shpalosur dobësitë në menaxhimin dhe raportimin e pasurisë me vlerë nën 1000 euro’. Mungojnë vlerat e pajisjeve të regjistruala si dhe inventarizimi I pasurisë.· Auditori thotë ‘Auditimi i këtij viti ka nxjerrë në pah se niveli i rekomandimeve të zbatuara nga viti kaluar ishte i ulët’. Edhe më tutje Komuna nuk posedon planin strategjik kundër korruptionit. Rekomandimet e Auditorit të brendshëm nuk zbatohen, nga gjithsej 20 rekomandime, vetëm 8 janë zbatuar. Pra, në bazë të te gjeturave dhe konstatimeve të auditorit, unë konsideroj se Komunës sonë i mbetet shumë për të dëshiruar!

**z. Selim Reka,** Vërejtjet e auditorit janë identifikuar në tre fusha, fusha 1 është më mirë, ndërkaq fusha 2 dhe 3 kanë më shumë të gjetura. Të gjeturat e auditorit, është të Kontratat e prokurimit për Mallra dhe Shërbime dhe ato për Investime Kapitale, ku thuhet së të gjitha dosjet e testuar, kontratat kanë aneks kontrata me vlerën 10% të kontratës. Kjo flet për një planifikim jo të mirë të buxhetit të komunës në këto programe shpenzuese buxhetore apo diçka më tepër. Vlerat e aseteve, shihet se komuna nuk i ka regjistruar ekonomitë financiare në vlerë nën 1000€, ndërkaq të pasuritë e regjistruala, shihet së nuk përputhen me vlerën financiare të pasurive jo financiare në regjistrin e aseteve të komunës. Nga Rekomandimet të cilat i ka dhënë auditori në vitin 2018, shihet se 8 rekomandime janë zbatuar plotësisht, 8 rekomandime janë në procedurë të zbatimit të tyre, ndërkaq 4 rekomandime janë të pazbatuara. Nga raporti shihet së komuna ka nivel të ulët të zbatimit të rekomandimeve nga viti i kaluar, pastaj mungon Plani kundër korruptionit. Nga të gjeturat e theksuara si në raportin e auditorit, shihet se mungon një kontroll menaxheriale në disa aktivitete të komunës.

**z. Nexhat Loku,** Vet fakti se në Raportin e auditorit të jashtëm, opinioni i auditorit është i “pa modifikuar me theksim të çështjes”, të bënë me kuptuar se nuk është keq aktiviteti i zhvilluar i komunës në vitin 2018. U përmend një shumë prej 350.000€ nga Adnani, unë nuk e di ku është e shënuar ajo shumë, nuk e kam vërejtur.

**z. Adnan Reka,** Shuma e mjeteve buxhetore është, 350.000€, potencuar në raport, f. 11 të Investimet Kapitale.

**Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Mërseli,** Buxheti i Komunës është e ditur së asnjëherë nuk mund të shpenzohet 100 %. Kjo është arsyja që sa herë duhet të kemi ndryshime buxhetore. Auditori thotë se ka pasur trend pozitiv të shpenzimeve të buxhetit. Me vet faktin që opinioni i auditorit në këtë raport është i pamodifikuar me theksim të çështjes, kjo jep një garancë për përfitimin e grantit të përformancës, sepse si kriter i parë është me qenë raporti i pamodifikuar. Të çështja e planit kundër korruptionit, e kemi planin e integritetit të cilin e kemi aprovuar, aty janë të parapara masat kundër korruptionit, ndërkaq çështja se a iu ka ofruar ky plan auditorit apo jo unë nuk e di. Të çështja e aneks kontrata me vlerën 10% të kontratës, kjo po ndodhë sepse kompanitë po e marrin tenderin më çmim më të ulët sesa vlera e projektit, kështu që mjetet të cilat po ngelin nga projektet, komuna po duhet me i shpenzuar diku e mos me u kthyer në suficit buxhetor.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi,** Është viti i tretë që komuna jonë nga Zyra e auditorit të jashtëm ka opinion për raport të pamodifikuar me theksim të çështjes, kështu që jemi në mesin e komunave më të mira. Të gjeljet, shqetësuese është pasuria e pa regjistruar nën vlerën 1000€, kështu në këtë drejtim është formuar një komision i cili do të angazhohet për regjistrimin e pasurisë së komunës së paregjistruar. Të çështja e mjeteve të ngelura, 350.000€, nuk është se kanë ngelur të gjitha këto mjete buxhetore, sepse vetëm 57.000€ kthehen në suficit buxhetor, ndërkaq këto të tjerat nuk janë suficit buxhetor, por janë mjete buxhetore nga të HVK, të cilat bartën për shpenzim në vitin vijues buxhetor. Të inkasimi i ulët i buxhetit të komunës, besoj së këtë vit kjo çështje do të rregullohet, do të mundohemi edhe përmes përbartuesve privat me i mbledhur borxhet që ia kanë komunës. personat fizik dhe personat juridik Të kontratat me anekse me 10% të vlerës së kontratës, kemi kontrata, në këtë vlerë, por jo shumë. Nëse mund të themi, jemi komuna që me së paku kemi kontrata të tilla, sivjet ka me pak. Të çështja e punësimeve me kontratë në vepër, kemi kontrata të tilla, por jo me vazhdimin e tyre mbi 6 muaj. Të Kontratat me anekse me 10 % të shumës së projektit, unë kam diskutuar me auditorin duke i paraqitur arsyet, sepse ka projekte që ngelin mjete buxhetore dhe ato mjete duhet me i shpenzuar diku, në disa raste edhe pengesat në teren na sfidojnë, kështu që lind nevoja e mbulimit të shumës së pa planifikuar me aneks kontratë. Sa i përket rekomandimeve jemi duke marrë veprime të nevojshme për zbatimin e tyre dhe shpresoj së të njëjtat do të zbatohen.

**z. Adnan Reka,** I kuptoj shqetësimet, sfidat, por të aneks kontratat auditori ka bërë vërejtje. Të Kontratat në vepër, ka pasur pranime të punëtorëve pa shpallje të konkursit në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Konstatimet e auditorit janë se ka pasur vazhdim të kontratave edhe pas 6 muajve. Sa i përket çështjes që thuhet se raporti i auditorit është i "pa modifikuar me theksim të çështjes", nëse do të kishim raporti e modifikuar, atëherë do t'i kishim krimet ekonomike këtu.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi,** Sqaroj për pranimet me kontratë në vepër pa procedurë konkurrimi, fjala për dy mjekë për shërbime javore të cilët paguhen nga 35€.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, raporti nuk del në votim, atëherë konstatoj se Kuvendi i Komunës u.

#### Njoftua

**Me Raportin e Auditimit për Komunën e Kaçanikut për vitin finanziar të përfunduar me 31 Dhjetor 2018.**

**3.** Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhënë në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare të Auditimit për PFV 2018:

**Kryesuesi i Kuvendit**, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka**, A ka ndonjë arsyе më tepër për të shpresuar se ky Plan i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit do të zbatohet, kur kemi parasysh se nga viti 2015 asnjëherë nuk janë zbatuar as gjysma e rekomandimeve të auditorit. p.sh për vitin 2015, nga 13 rekomandime të Auditorit, vetëm 2 janë zbatuar, për vitin 2016, nga 24 rekomandime të Auditorit, vetëm 9 janë zbatuar, për vitin 2017, nga 13 rekomandime të Auditorit, vetëm 5 janë zbatuar. Pse duhet të shpresojmë se këto rekomandime do të zbatohen, kur dihet se auditori jep vetëm rekomandime dhe opinione, por jo edhe dënimë.

**z. Festim Neziraj**, Unë kam qenë pjesë e komisionit, këtë punë e kemi marrë me seriozitetin më të madh, kemi ndjekur trajnime edhe nga DEMOS, besoj se sukseset nuk do të mungojnë në zbatimin e rekomandimeve të dhëna si në raportin e auditorit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Plan e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit, shumica e votave ishin Për, Kundër ishin 2 anëtarë, Abstenuan 8 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

#### VENDIM

**Me të cilin e Aprovoj Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhënë në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare të Auditimit për PFV 2018/ Lënda: 01Nr. 470/03-21361/19.**

**4.** Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën: Janar-Qershori 2019;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçiku**, Nga Raporti shihet së buxheti i komunës nuk është realizuar ashtu sa është planifikuar si të realizimi i shpenzimeve ashtu edhe të inkasimi i të HVK. Kur jemi të te HVK, shihet së inkasimet janë të ulëta të disa drejtori komunale, me përjashtim të dy drejtorive, DEFZH dhe DBPZHR, ndërkaq nuk ka të hyra nga shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe nga inspektorati.

Të Tabela 3 pika 1. shihet së Pagat dhe Mëditjet të Zyra e Kryetarit të Komunës shpenzimet janë rritur, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018, më intereson të di, cila është arsyja e rriyjes së këtyre shpenzimeve?

Të Tabela 4, Planifikimi i buxhetit dhe alokime, shihet së janë alokuar diku, 5 milion euro, ndërkaq janë shpenzuar diku 3 milion euro, e që kujtoj së është një diferençë e madhe e mjeteve të alokuara në raport me ato të shpenzuara.

Të Subvencionet e DAK, janë ndarë mjete buxhetore për projektin; Organizimin dhe mbajtjen e festivalit, ndërkaq mjetet buxhetore të ndara për këtë projekt janë shumë të madhe, e cila shumë nuk mund e di sa mund të arsyetohet.

**z. Selim Reka**, Në Raporti financiar shihet së të HVK ose janë planifikuar keq ose janë dështuar realizimi i tyre. Të Hyrat nga gjobat, shihet së gjendja e tyre është me e mirë, sepse

kemi më tepër të HVK në periudhën raportuese në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2018. Shkalla me e ulët e realizimit të HVK është tek të pozicioni për, Mallra dhe Shërbimet. Të Shpenzimet Kapitale ekziston shkallë e ulët e realizimit të tyre, me çka ekziston frika që mjetet buxhetore të kthehen në suficit buxhetor. Të alokimi i mjeteve buxhetore, nga raporti shihet së ka më tepër mjete të alokuara sesa të shpenzuara. Në KPF e bëra një pyetje drejtorit për shpenzimet buxhetore të krijuara për dreka zyrtare për organizimet e memorialit, Feriz Guri në vlerë 700€, të cilat shpenzime kujtoj së janë të mëdha për një organizim të tillë.

**z. Ekrem Raka,** Nga Raporti finansiar shihet se dinamika e realizimit të buxhetit është e vogël dhe nëse vazhdohet me këtë trend, atëherë vështirë se mund të realizohet buxheti i planifikuar. Të pozicioni i pagave dhe mëditjeve, më intereson të di, përsë janë rritur shpenzimet në këtë program shpenzues buxhetor, kur dihet se nuk kemi pasur rritje të pagave të punëtorëve.

**Kryetari i Komunës,** Dihet se me zhvilluar procedura për realizimin e projekteve, koha me e mirë është muaji Maj, ndërkaq janë do procedura që na vonojnë në realizimin e projekteve kapitale. Nëse analizojmë reportin finansiar të komunës tonë me komunat tjera, atëherë shihet së qëndrojmë më mirë sesa komunat tjera në realizimin e buxhetit. Të drekat zyrtare, për organizimet e memorialit Feriz Guri, në vlerë 700€, në atë organizim përkujtimor ka qenë edhe Klubi i Mundjes, ka pasur edhe mysfirë të ftuar, kështu dreka është realizuar të restoran "Beni", kjo është arsyja e shpenzimit të shumës së mjeteve për realizimin e këtij projekti.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kjo ishte sa për njoftimin e juaj, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

#### Njoftua

**Raporti Gjashtëmujor Financiar për periudhën: Janar-Qershori 2019.**

#### **5. Raporti i Përformances Komunale për vitin 2018;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin për këtë pikë e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Shpend Krusha,** Nga Raporti shihet se si komunë jemi ranguar në vendin e 15 në bazë të aktiviteteve të zhvilluara të komunës, ndërkaq duhet bërë edhe me tepër në ato shërbime ku komuna ka ngecje apo nuk kemi të arritura fare aktivitete të mundohemi me u përmirësuar. Të barazia gjinore, kjo është e theksuar, ashtu që nuk kemi barazi gjinore në pozicionet vendimmarrëse. Në shkollat e komunës është vetëm një femër drejtore, gjithashtu vetëm një femër është në organin ekzekutiv të komunës. Çështja e barazisë gjinore në pozitat vendimmarrëse duhet të merret parasysh në të ardhmen. Të çështja e punësimeve të personave me nevoja të veçanta, ngecim në këtë drejtim si komunë, kështu në të ardhmen duhet me iu dhënë përparësi punësimeve të këtyre personave. Të çështja e ujit të pjes, nuk janë të përfshira të gjitha familjet në rrjetin e ujësjellësit dhe uji i pjes nuk kontrollohet, kjo është shqetësuese jo vetëm furnizimi me ujë por edhe mungesa e kontrollimit të ujit të pjes.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Sa i përket aktiviteteve të Kuvendit të Komunës 100% janë përmbrushur- të gjitha, ndërkaq të çështjet e Ekzekutivit të Komunës, janë krerët e

ekzekutivit të komunës këtu të cilët mund të jepin sqarime të nevojshme, mirëpo duhet ta kemi parasysh një çështje së; jo të gjithë treguesit munden me u përmbushur, si të çështja e disa shërbimeve të ekzekutivit e kështu me radhë, sepse disa çështje varen edhe nga faktorë të tjera.

**z. Festim Neziraj,** Në rangim sipas raportit nuk jemi keq, shihet se ka rritje të grantit të përformancës për 10%. Në vitin 2018 kemi pasur disa treguesit të cilët nuk janë përmbushur sa duhet. Jemi duke u angazhuar në këtë drejtim me u përmirësuar aty ku ka mundësi me qëllim që këtë vit të arrijmë përfitim më të madh të grantit të përformancës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Raporti i përformancës ishte sa për njoftimin tuaj, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës, u,

#### Njoftua

#### Me Raportin e Përformances së Komunës së Kaçanikut për vitin 2018.

**6. Propozim Vendimi për rialokimin dhe transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Në mungesë të drejtorit të DEFZH , Bahri Selimi për arsyet e njoitura, për sqarime të nevojshme në këtë pikë fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani.

**z. Ramadush Osmani,** U diskutua çështja e 10% të Kontratave të Prokurimit dhe të punësimet me kontrata në vepër. Lidhur me këto çështje iu njoftoj së nga 31 procedura të prokurimit, 23 procedura janë të përfunduara, ndërkaj 12 apo 13 procedura janë në ekzekutim e sipër. Mungesa e rishikimit buxhetor po na imponon me bërë rialokim dhe transfer të mjeteve buxhetore. Janë evidentuar të gjitha projektet e realizuar dhe mbetjet e tyre, të cilat mbetje i kemi projektuar me i shpenzuar diku tjetër. Në vazhdim drejtori i përmendi projektet nga të cilat kanë mbetur mjete buxhetore dhe theksoj se me këto mjete buxhetore do të bëhet ndërtimi i rrugëve në f. Biçec- Kovaçec, duke përmendur rëndësinë e projektit dhe lagjet përshkojnë këtë rrugë. Sa i përket 10 % të shumës së kontratës së projekteve, nuk jemi duke e aplikuar në shumë të projektet edhe pse me ligj është e lejuar.

**Kryesuesi i Kuvendit,** I dëgjuat sqarimet e drejtorit, Ramadush Osmani, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçku,** Rialokimi dhe transferi i mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 të përcaktuara si në Propozim Vendim, janë pasojë e planifikimit jo të mirë të buxhetit të komunës. Duke u nisur nga ky fakt, ne subjekti politik i LVV nuk do të votojmë këtë Propozim Vendim kur të shtrohet në votim.

**z. Ekrem Raka,** Më intereson të di arsyen që iu ka shtyrë që të gjitha këto mjete buxhetore të ngelura nga projektet tjera kapitale, me i transferuar vetëm të një projekt kapital ?

**z. Ramadush Osmani,** Arsyja është se jemi në fazën e gjashtëmujorit të fundit, ndërkaj projekt i paraparë për realizimin e projektit në shumën 11.000€ nuk mund të realizohet, ndërkaj ndërtimin e rrugës në Kovaçec e cila rrugë lidhë shumë lagje të Biçecit me përjashtim të lagjes Palloshi, dhe është rrugë shumë më e shkurtër sesa rruga ekzistuese.

Të çështja e mbetjeve buxhetore nga realizmi i projekteve kapitale, planifikimi bëhet me i madh, ndërkaq kompania hynë në tender më vlerë më të vogël sesa kushton projekt, kjo është arsyaja pse ngelin mjete buxhetore të pa shpenzuara nga projektet kapitale.

**z. Shpend Krusha,** Gabimi thuhet se është të inxhinierët në projektimin e çmimit të projekteve, ndërkaq sa e di unë, tenderi duhet me qenë i përafërt me çmimin e projektit.

**Kryetari i Komunës,** Inxhinierët e planifikojnë me çmimin e tregut projektin, por kemi raste kur kompania hynë me një çmim shumë më të ulët sesa është tregu. Unë nuk e di kjo çështje a është punë e konkurrencës apo e inateve mes kompanive që hynë më çmim më të ulët në tender sesa kushton projekt.

**znj. Hafize Sallahu,** Kur jemi të ky projekt i cili do të realizohet me këto mjete buxhetore të cilat po rialokohen dhe transferohen, ky projekt lidhë shumë lagje të komuniteteve Biçec dhe Kovaçec, kështu që është shumë i nevojshëm dhe i mirëseardhur për ato komunitete.

**z. Shemsedin Luzha,** Çdo rrugë e cila asfaltohet , duhet me qenë kualitative, e jo siç është rasti me rrugën e f. Begracë, e cila është shkatërruar pak kohë pas ndërtimit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit ishte, 19 votë Për, Kundër ishin 6 anëtarë, Abstenuan 2 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë<

#### VENDIM

**Për rialokimin dhe transferin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2019 / Lënda: 01Nr. 400/01-22496.**

7. Raporti final i rekomandimit të Panelit Përgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Sqaroj së ky raport është një ndër raportet me të kompletuara deri më tanë. Për këtë e përgëzoj komision për punën të cilën e ka bërë, ndërkaq fjalën ia jap anëtarit të komisionit, Shpend Krusha për sqarime të nevojshme.

**z. Shpend Krusha,** Si komision jemi munduar me qenë korrekt në përzgjedhjen e anëtarëve të këtij komiteti. Pyetjet janë bërë nga komisioni aty për aty dhe atë, vetëm një orë para se me u intervistuar kandidatët aplikantë. Secili nga ne anëtarët e komisionit kemi bërë nga një pyetje dhe kujtoj se është bërë një punë e mirë dhe nuk ka vend për ankesa.

**Kryesuesi i Kuvendit,** I dëgjuat sqarimet e anëtarit të panelit përgjedhës, Shpend Krusha, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Bekim Koxha,** Unë nuk kam informacione sa janë profesionist dhe të drejtimit adekuat kandidatët e propozuar për anëtarë të Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Vlerësimet i ka bërë Paneli përgjedhës, ndërkaq sa i përket profesionalizimit, për këtë fushë është vështirë me gjetur njerëz profesionist. Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim; Rezultati i votimit ishte njëzëri Për. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

### VENDIM

Për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçaniku, të themeluar me Vendim të Kuvendit të Komunës 01Nr. 104/02-34370/18 të datës 30 Tetor 2018, me përbërje:

1. Argjenta Axhami,
2. Artan Mezraja,
3. Mirlinda Axhami-Hysa,
4. Fiknete Krasniqi,
5. Edita Shehu,
6. Albana Fuga, dhe
7. Antigona Axhami-Baftijaj.

**8. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr.104/02-18863/19- të datës 28.06.2019 –Për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;**

Edhe për këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit e hapi diskutimin por nuk u paraqit kush për diskutim, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

### VENDIM

**Për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr.104/02-18863/19- të datës 28.06.2019 –Për formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.**

Ndryshimet janë: Nga komisioni i ankesave hiqet anëtari nga Ekzekutivi i Komunës, Mentor Shehu, me kërkesën e tij, ndërkaq në vend të tij emërohet, Edmond Mjaku, anëtar nga Ekzekutivi i Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Para së më përfunduar mbledhjen, i bëri disa njoftime për KK, njëra prej tyre ishte së në muajin Gusht nuk do të ketë seanca të KK, pos debateve publike të cilat do të organizohen për buxhetin e komunës të vitit 2020.

**z. Bekim Koxha,** Jep vërejtje se nuk kam marrë përgjigje në kërkesat e mia të ngritura në mbledhjen e kaluar të KK, ndërkaq shtoj se nëse kjo ndodhë edhe herëve të tjera, atëherë unë në këtë kuptim do ta lëshoj mbledhjen e KK.

**Kryesuesi i Kuvendit- Kemal Mërseli,** Ia bëri me dije z. Bekim Koxha së janë shpërndarë përgjigjet në kërkesat e juaja para së më filluar mbledhje dhe besoj së përgjigjet i keni në tavolinë. Diçka tjetër për këtë takim nuk ka kështu e konstatoj mbledhjen e kuvendit të përfunduar. Ora e përfundimit të mbledhjes, 12:15. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 27 anëtarët-të gjithë.

Procesmbajtës  
Makfiqe Malsiu



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS  
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**nga Mbledhja e VII (Shtatë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019, mbajtur me 30 Korrik 2019.**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....
12. Shpend Krusha.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili .....
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,



## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 26. 09. 2019

Për: Anëtarët e Kuvendit: z. **Shpend Krusha,**  
z. **Ekrem Kyçyku,**  
z. **Shemsedin Luzha,**

### Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtuara para Kuvendit të Komunës, më datë 30. 07. 2019, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Emergjencave dhe Shërbimeve Publike.

**Shpend Krusha**, Shprehi shqetësimet lidhur me banorët e lagjes të “Saniteksi” të afér 80 shtëpive të banimit dhe të disa shtëpive të lagjeve të tjera të cilët banojnë në lartësi, përmungesën e ujit të pijes. Lidhur me këtë problematikë z. Krusha theksoj së duhet bërë një zgjidhje, ashtu që me biseduar me drejtorin e kompanisë së ujësjellësit “Lypeteni” së a ka mundësi me u furnizuar me ujin e pijes qytetarët të cilët banojnë në lartësi (jo vetëm në qytet por edhe në fshatra), përmes pompave të ujit. Uji është çështje jetike e njeriut, andaj mungesa e ujit mund të sjellë edhe probleme të infeksioneve të qytetarëve të komunës.

➤ *Me ndërtimin e rezervuarit 1000m<sup>3</sup>, i cili është në një kuotë me të lartë se rezervuari ekzistues, janë krijuar mundësítë që të furnizohen edhe shtëpitë dhe lagjet që aktualisht janë pa sistem të ujësjellësit. Në bashkëpunim me KRU “Bifurkacioni” njësia operative jemi duke shqyrtuar mundësítë që të bëhet shtrirja e rrjetit të ujësjellësit edhe në këtë zonë.*

### z. Ekrem Kyçyku,

Kam një kërkesë në emër të banorëve të lagjes, “Mejdi Dalloshi” në Kaçanik për lëvizje të lirë të qytetarëve në atë rrugë, sepse në mungesë të parkingjeve, parkohen auto veturat në atë rrugë, me çka po iu krijohet vështirësi qytetarëve të asaj lagjeje të lëvizin lirshëm. Lidhur me këtë problematikë kërkoj një angazhim më të madh të organet relevante të komunës për krijimin e kushteve qytetarëve të komunës për lëvizjen e lirë në atë rrugë.

➤ *Gjërsia aktuale e rrugës “Mejdi Dalloshi” nuk mundëson planifikimin e parkingjeve përgjatë trasesë së saj. Në kuadër të projektit “Rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal” planifikojme vendosjen e shenjave të nevojshme të trafikut (vertikale dhe horizontale), në rrugët e qytetit dhe shenjëzimin e vendparkingjeve (aty ku ekziston hapësirë). Në rastet ku hasen veturat e parkuara në vendet e ndaluara me shenjë trafiku, do të veprojnë organet kompetente.*

**z.Shemsedin Luzha,**

1. Kam një kërkesë në emër të lagjes së f. Begracë, për çështjen e mungesës së ujit të pijes, për shkak të dëmtimit të rrjetit të ujësjellësit.

2. Kërkesa tjetër; Në emër të f. Begracë e ngriti çështjen e problemit të kanalizimit, sepse gypi i kanalizimit është mbi tokë. Lidhur me këtë çështje ka pasur kërkesë nga f. Begracë për rregullimin e gypit në fjalë, por nuk është marrë ndonjë veprim në këtë drejtim nga organet relevante të komunës.

- 1. *KRU "Bifurkacioni"-si kompani përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit në fshatin Begracë, ka bërë sigurimin e një pompe shtesë për furnizim të ujit nga puset aktuale dhe është stabilizuar dukshëm gjendja e furnizimit me ujë në këtë zonë.*
- 2. *Kompania e kontraktuar për mirëmbajtjen e kanalizimeve fekale dhe atmosferike ka intervenuar dhe është sanuar defekti i paraqitur në rrjetin e kanalizimit në rrugën "Rexhep Luzha"-Begracë*

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

Me respekt,

Ramadush Osman  
Drejtor i DSHPE-së